

**UDHËZIM**  
**Nr.36, datë 9.9.2011**

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.25, DATË 20.7.2011 “PËR PROCEDURAT  
E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE ME  
KOHË TË PLOTË NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË PËR  
VITIN AKADEMIK 2011-2012”**

Në mbështetje të nenit nr.102 të Kushtetutës, pika 5, të nenit 33 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të vendimin nr.423, datë 8.6.2011, të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimi në institucionet publike të arsimit të lartë, cikli i parë i studimeve me kohë të plotë, si dhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2011-2012”, të vendimit nr.78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike”, të ndryshuar, të vendim nr.1013, datë 10.12.2010 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP), si dhe të vendimit të Këshillit Ministrave nr.241, datë 31.3.2011 “Për kryerjen nga Posta Shqiptare sh.a, të shërbimeve postare, financiare dhe shërbimeve tjera, që janë në përputhje me veprimtarinë e kësaj poste, për institucionet e qeverisjes qendrore e vendore, institucionet e tjera publike, si dhe shoqëritë tregtare me kapital shtetëror”,

**UDHËZOJ:**

1. Germa “d” e pikës 7.2 të udhëzimit nr.25, datë 20.7.2011 “Për procedurat e pranimi dhe të regjistrimit në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë për vitin akademik 2011-2012”, të ndryshojë si më poshtë:

“d) Mandatarkëtimi i tarifës së regjistrimit prej 1. 550 lekë, paguar për llogari të universitetit, në çdo filial të Postës Shqiptare sh.a.”

2. Ngarkohen Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP), Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS**  
**Myqerem Tafaj**